# Të drejtat tuaja për akses gjuhësor

## në Shtetin e Nju-Jorkut

NEW YORK STATE
Office of General Services
Office of Language Access

**Ligji për aksesin gjuhësor i Shtetit të Nju-Jorkut**

Njujorkezët flasin më shumë se 800 gjuhë. Për t'u siguruar që të gjithë njujorkezët të mund të kenë akses në shërbime dhe përfitime publike - pavarësisht komunikimit të tyre në anglisht - guvernatorja Kathy Hochul nënshkroi kthimin në shndërrimin në ligj të politikës për akses gjuhësor të Shtetit të Nju-Jorkut dhe krijoi Zyrën për Akses Gjuhësor (Office of Language Access) në nivel shteti. Zyra për Akses Gjuhësor, brenda Zyrës së Shërbimeve të Përgjithshme (Office of General Services) është përgjegjëse për të garantuar që agjencitë e Shtetit të Nju-Jorkut të mbuluara nga ky ligj ta zbatojnë atë me efektivitet dhe efikasitet.

**Sipas ligjit, agjencitë e Shtetit të Nju-Jorkut që ofrojnë shërbime ose përfitime për publikun duhet të:**

1. Ofrojnë shërbime interpretimi për personin që merr shërbime ose përfitime në gjuhën parësore, duke përfshirë gjuhën amerikane të shenjave (American Sign Language, ASL).
2. Përkthejnë dokumente të rëndësishme që lidhen me shërbimet ose përfitimet e tyre në 12 gjuhët kryesore të folura nga njujorkezët që nuk flasin shumë mirë anglisht. Agjencitë mund të zgjedhin gjithashtu t'i përkthejnë dokumentet e tyre të rëndësishme deri në katër gjuhë të tjera në bazë të kritereve të detajuara në ligjin për aksesin gjuhësor.
3. Zgjedhin një Koordinator për Aksesin Gjuhësor (Language Access Coordinator) që do të punojë me Zyrën për Akses Gjuhësor për t'u siguruar që agjencia e tyre e zbaton ligjin për aksesin gjuhësor.
4. Publikojnë Planin e tyre për Akses Gjuhësor (Language Access Plan) në faqen e internetit të agjencisë së tyre dhe ta përditësojnë një herë në dy vjet.

Zyra për Akses Gjuhësor publikon çdo vit një raport rreth këtyre shërbimeve.

Vizitoni faqen **languageaccess.ny.gov** për më shumë informacion rreth Zyrës për Akses Gjuhësor, agjencive të mbuluara nga ligji për akses gjuhësor dhe për të dhënë komente rreth përvojës suaj në marrjen e shërbimeve të aksesit gjuhësor.

Ka 2,5 milionë njujorkezë që nuk flasin anglisht shumë mirë. Më poshtë listohen dymbëdhjetë gjuhët kryesore që fliten më gjerësisht në Nju-Jork, përveç anglishtes:

- Arabisht
- Bengalisht
- Kinezisht (duke përfshirë dialektin kantonez dhe mandarin)
- Frëngjisht
- Kreolishte e Haitit
- Italisht
- Koreanisht
- Polonisht
- Rusisht
- Spanjisht
- Urduisht
- Jidisht

**Si ta përdorni kartën "I Speak" (Unë flas)**

Me këtë broshurë mund të merrni një kartë "I Speak" (Unë flas). Ju mund ta përdorni atë për të identifikuar gjuhën tuaj të preferuar. Mund ta mbani kartën me vete dhe t'ia tregoni stafit të çdo agjencie të Shtetit të Nju-Jorkut të mbuluar nga ligji për aksesin gjuhësor, kur kërkoni shërbimet ose përfitimet e tyre. Kjo do ta ndihmojë stafin e agjencisë të kuptojë se si të gjejë interpretin e duhur për ju. Gjithashtu, mund ta shkarkoni kartën në telefonin tuaj - thjesht ndiqni hapat më poshtë.

**Shkarkimi i kartës në telefon:**

1. Skanoni kodin QR.
2. Zgjidhni gjuhën tuaj nga lista.
3. Klikoni ikonën në cepin e sipërm djathtas për ta ruajtur në telefon.
4. Hapni kartën dhe tregojani stafit sa herë që vizitoni një agjenci shtetërore për të marrë shërbimet ose përfitimet e tyre.



**A e dinit se...?**

Gjuha amerikane e shenjave (American Sign Language, ASL) është gjuha kryesore e shumë personave në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada. Edhe pse ASL është gjuha e shenjave e përdorur më gjerësisht nga personat që nuk dëgjojnë dhe ata me vështirësi dëgjimi në Shtetet e Bashkuara, ajo nuk është universale. Ka shumë variante të gjuhës së shenjave që përdoren në rajone të ndryshme, si gjuha britanike e shenjave, gjuha franceze e shenjave ose gjuha kineze e shenjave. Gjuhët e shenjave mund të kenë një strukturë shumë të ndryshme nga gjuhët e folura. Ashtu siç i ndodh kujtdo që e mëson anglishten si gjuhë të dytë, përdoruesit e ASL-së mund ta kenë të vështirë të komunikojnë në anglisht dhe, sipas ligjit për aksesin gjuhësor, gëzojnë të drejtën e një interpreti kur kërkojnë shërbime ose përfitime nga agjencitë e Shtetit të Nju-Jorkut.